



KODI I SJELLJES I KRKA'S



DISPOZITAT HYRËSE	1
PARIMET ETIKE THEMELORE	1
Respekti	1
Bashkëpunimi	2
Ekselenca	2
Integriteti i menaxhmentit	4
INTEGRITETI I KORPORATËS	4
Ndalimi i mashtrimit dhe korrupsionit	4
Konflikti i interesave	5
Promovimi i produkteve	5
Furnizuesit dhe partnerët afaristë	6
Konkurrenca e ndershme	6
PËRGJEGJËSIA SOCIALE	6
ZYRTARI KRYESOR PËR PAJTUESHMËRI	7
RAPORTIMI I SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME	7
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	8

DISPOZITAT HYRËSE

Kodi i Sjelljes i Krka-s (në tekstin e mëtejshëm "*Kodi*") i përcakton parimet dhe rregullat për sjelljen etike, praktikat e mira të biznesit dhe standardet e sjelljes në Krka, dd, Novo mesto dhe filialet e saj (më tej "Krka"), të cilat janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e Krka-s. Ky *Kod* konsiderohet si bazë për të gjitha rregullat e tjera të brendshme të Krka-s.

Parimi themelor i të gjithë punonjësve të Krka-s është sjellja konsistente sipas standardeve dhe parimeve më të larta morale që e rregullojnë ndershmërinë, besnikërinë dhe profesionalizmin, si dhe pajtueshmërinë e vazhdueshme me rregulloret dhe udhëzimet e dhëna nga organizatat ndërkombëtare për industrinë farmaceutike, si dhe me rregullat e brendshme të Krka-s.

Ky *Kod* është në dispozicion të publikut në faqen e internetit të Krka-s <https://www.krka.biz/sl/>. Partnerët afaristë të Krka-s mund të familjarizohen me *Kodin*, meqë ne presim që ata t'i përmbahen atij përderisa bëjnë biznes me Krka-n.

PARIMET ETIKE THEMELORE

Parimet etike themelore të Krka-s janë respekti, bashkëpunimi, ekselencia dhe integriteti i menaxhmentit, si në marrëdhëniet midis punonjësve, ashtu edhe në marrëdhëniet e jashtme.

Si punonjës të Krka-s, ne jemi të vetëdijshëm se pajtueshmëria me parimet themelore ndihmon në realizimin e vizionit të Krka-s, arritjen e rezultateve të planifikuara të biznesit, mbrojtjen e reputacionit të Krka-s dhe kontributin në zhvillimin e një mjedisi shoqëror më të gjerë në të cilin veprojmë.

Respekti

Mundësitë e barabarta për të gjithë, respektimi i normave ligjore dhe qasja etike ndaj njerëzve të tjerë dhe komunitetit shoqëror më të gjerë paraqesin bazën e punës sonë. **Ne i respektojmë të drejtat e njeriut** siç janë përcaktuar në parimet dhe udhëzimet e njohura ndërkombëtarisht. Ne veprojmë sipas rregulloreve dhe standardeve ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në të gjitha vendet ku Krka është e pranishme.

Ne e respektojmë dinjitetin, integritetin personal dhe privatësinë e çdo individ. Ne gjithashtu e respektojmë lirinë e fjalës dhe shprehjes së mendimit dhe i trajtojmë gjithmonë të tjerët me respekt. Ne komunikojmë hapur me kolegët tanë, pa marrë parasysh kualifikimet profesionale dhe pozitën udhëheqëse të tyre. Ndalohen të gjitha format e punës së padrejtë dhe të paligjshme.

Ndalohet çdo diskriminim ndaj punonjësve. Punonjësit trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga kombësia, raca apo prejardhja etnike, prejardhja kombëtare apo sociale, gjinia, ngjyra, shëndeti, aftësia e kufizuar, feja apo besimi, mosha, orientimi seksual, gjendja familjare, anëtarësia në sindikata, stabiliteti financiar apo rrethana e tjera personale.

Ndalohen të gjitha format e ngacmimit dhe keqtrajtimit në vendin e punës. Ne ofrojmë kushte të drejta pune dhe mjedis pune të hapur dhe kreativ. Ne e ofrojmë një mjedis pune pa presion psikologjik, ngacmime seksuale apo të tjera, apo keqtrajtime nga punonjësit e tjerë, eprorët apo palët e treta. Të gjithë duhet të përmbahemi nga çdo veprim i papërshtatshëm që e rrezikon dinjitetin e një personi tjetër. Ne duhet t'ia raportojmë eprorit apo udhëheqësit të njësisë organizative menjëherë çdo sjellje të papërshtatshme të zbuluar apo të shprehur nga ndonjë punonjës. Çdo sjellje e papërshtatshme e zbuluar apo e shprehur nga ndonjë epror duhet t'i raportohet menjëherë eprorit të tij apo personit të autorizuar për trajtimin e situatave të ngacmimit në grup. Çdo punonjës mund t'ia raportojë ngacmimin në grup çdo personi përkatës të autorizuar. Rregullat e sjelljes në rast të ngacmimit në grup dhe një listë e personave të autorizuar për t'u marrë me situatat e ngacmimit në grup publikohen në Krkanet, në faqen e brendshme të Krka-s. (**Rregullat e sjelljes në rast të ngacmimit në grup**)

Ne ofrojmë mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm ku punonjësit nuk u ekspozohen rreziqeve shëndetësore. Ne gjithashtu miratojmë rregullisht masa për zvogëlimin dhe eliminimin e rreziqeve të mundshme shëndetësore dhe aksidenteve. Të gjithë duhet t'u përmbahen të gjitha rregulloreve dhe rregullave të brendshme që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë në punë. Parimi ynë themelor është një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm; prandaj punonjësit nuk duhet të punojnë ose të jenë të pranishëm në mjedisin e punës nën ndikimin e alkoolit,

drogës apo substancave të tjera të ndaluara. Pirja e duhanit ndalohet në të gjitha vendndodhjet e Krka-s. Puna jonë duhet të kryhet me kujdes në mënyrë që të mos e rrezikojmë jetën dhe shëndetin tonë, si dhe jetën dhe shëndetin e njerëzve të tjerë. Pajisjet e punës, pajisjet e sigurisë dhe pajisjet e mbrojtjes personale duhet të përdoren sipas qëllimit të tyre dhe udhëzimeve të punëdhënësit, ndërsa duhet të përdoren me kujdes dhe të mirëmbahen në gjendje të përkryer.

Edukimi dhe trajnimi i rregullt në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, sigurinë nga zjarri dhe mbrojtjen e pronës janë detyrim i çdo punonjësi, përfshirë informimin e eporëve për çdo mangësi dhe rrezik në mjedisin e punës dhe vendin e punës.

Bashkëpunimi

Në mjediset në të cilat ne veprojmë, ne bashkëpunojmë me aktorë të ndryshëm – aksionarë, punonjës, furnitorë, klientë, institucione, organizata të shoqërisë civile dhe individë. Ne e inkurajojmë bashkëpunimin e bazuar në respektin e ndërsjellë dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të ndryshme, duke u fokusuar në rritjen e vlerave të Krka-s.

Të gjitha marrëdhëniet me fushat mjekësore, farmaceutike dhe veterinare përqendrohen në ofrimin e informatave profesionale dhe objektive për produktet tona, duke siguruar dobi më të mëdha për pacientët dhe përdoruesit, duke e përmirësuar kujdesin mjekësor dhe duke e mundësuar shkëmbimin e njohurive dhe aftësive të ekspertëve. Ata u nënshtrohen edhe rregulloreve dhe rregullave të brendshme strikte si dhe standardeve të larta etike.

Publikut profesionalë i jepen informata objektive për produktet e Krka-s, cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e tyre. Zhvillimi, prodhimi, shitja dhe promovimi i produkteve tona përfshin bashkëpunimin me organizatat shëndetësore si spitalet, klinikat, universitetet dhe institucionet e tjera arsimore, autoritetet rregullatore dhe agjencitë publike që merren me barnat, ku ne i respektojmë të gjitha rregulloret dhe sigurojmë dokumentacion transparent.

Ne jemi të përkushtuar ndaj **raportimit gjithëpërfshirës dhe transparent për veprimtarinë e kompanisë** si dhe ofrimin e informatave të plota, të drejta, në kohë dhe relevante për autoritetet rregullatore, aksionarë, investitorët, mediat, analistët dhe publikun e gjerë. Të gjitha raportet, informatat financiare dhe të biznesit përgatiten dhe publikohen sipas rregulloreve dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit. Gjatë punës dhe raportimit, ne jemi të vetëdijshëm se suksesi ynë bazohet në një komunitet shoqëror më të gjerë dhe se ne duhet të veprojmë përherë në mënyrë që janë të dobishme për palët tona të interesit.

Ekselencia

Ne ofrojmë **produkte efikase, cilësore dhe të sigurt**. Efikasiteti, cilësia dhe siguria e produkteve monitorohen në të gjitha fazat e ciklit jetësor të tyre, nga krijimi e deri te përdorimi i tyre, përfshirë përmes marrjes së reagimeve. Ne e kemi një sistem të krijuar të raportimit dhe mbledhjes së informatave për efektet anësore ndaj produkteve mjekësore, i cili mundëson veprim të menjëhershëm.

Kërkimet dhe zhvillimi ynë, si dhe bashkëpunimi ynë me sektorin e mjekësisë dhe partnerët afaristë na ndihmojnë që t'i përmirësojmë njohuritë tona në fushën e farmacisë, në bazë të të cilave ne mund të kontribuojmë në vazhdimin e krijimit të produkteve mjekësore cilësore. Ne sigurojmë që hulumtimet që i bëjmë të jenë të pavarura dhe profesionale, që rezultatet e hulumtimeve të ruhen dhe raportohen siç duhet dhe që reagimet të merren përherë në konsideratë.

Jemi të përkushtuar që pacientëve, përdoruesve, punonjësve të shëndetësisë, publikut profesional, autoriteteve rregullatore, partnerëve afaristë dhe blerësve t'u ofrojmë informata të drejta, të plota dhe në kohë për produktet tona.

Të gjitha informatat që na vihen në dijeni gjatë punës sonë paraqesin asete të kompanisë, të cilat ne jemi të obliguar që t'i mbrojmë edhe pas përfundimit të punësimit tonë në Krka. Zbulimi i informatave të brendshme të ndjeshme dhe konfidenciale apo veprimi në bazë të tyre ndalohet dhe mund të rezultojë në procedura të punësimit, administrative, civile dhe penale kundër kompanisë dhe individit që i zbulon ato.

Punonjësit duhet t'i ruajnë **informatat** e klasifikuara apo që konsiderohen si konfidenciale për nga natyra si konfidenciale, ndërsa nuk duhet t'i shfrytëzojnë ato për përdorim personal apo t'i zbulojnë ndonjë pale të tretë

brenda apo jashtë kompanisë pa aprovim paraprak. Kjo vlen posaçërisht për informatat afariste që janë veçanërisht të ndjeshme, të dhëna teknike dhe informacione komerciale, informatat e tjera për kompaninë dhe punonjësit, dhe informatat për palët e treta. Punonjësit duhet t'u përmbahen të gjitha rregullave dhe procedurave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e informatave. Edhe informatat konfidenciale dhe pronësia intelektuale e partnerëve afaristë dhe palëve të treta duhet të mbrohen me kujdes. ([Rregullat për përcaktimin dhe ruajtjen e sekreteve tregtare](#))

Kur dyshojmë nëse ndonjë informatë e caktuar është e ndjeshme dhe konfidenciale, ne duhet ta trajtojmë si tejet konfidenciale dhe të konsultohemi për të me pronarin e saj apo me Zyret Ligjore. Ne e respektojmë politikën e tavolinës së pastër dhe ekranit të pastër. Nëse me e-mail dërgohet përmbajtje e ndjeshme, ne duhet të sigurohemi që bashkëngjitja që e përmban atë përmbajtje është e mbrojtur siç duhet nga qasje e paautorizuar. Ne nuk dërgojmë letra zinxhir, shaka apo përmbajtje të tjera të papërshtatshme me e-mail. Ne nuk klikojmë në vegëza të paverifikuara në internet dhe nuk hapim bashkëngjitje nga burime të panjohura në e-mail nga dërgues të panjohur, meqë mund të bëhemi viktimë të ndonjë sulmi kibernetik. **Zyrtari i Sigurisë së Informatave** i Krka-s i organizon, udhëheq dhe bashkërendon aktivitetet për garantimin e sigurisë së informatave. Punonjësit mund t'i drejtohen Zyrtarit të Sigurisë së Informatave me iniciativë dhe mendime apo nëse vërejmë ndonjë mangësi në këtë fushë. ([Rregullat për përdorimin e duhur të teknologjisë së informacionit](#))

Çdo e dhënë personale duhet të trajtohet me kujdes, në mënyrë transparente dhe të sigurt dhe në përputhje me rregulloret në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale duhet të mblidhen vetëm kur kjo është e nevojshme për përmbushjen e kërkesave legjislative dhe interesave legjitime të Krka-s, ose me pëlqimin personal të ndonjë individi që mund të tërhiqet në çdo kohë.

Nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave personale janë shkelur, drejtojuni eporrit tuaj për këshilla ose kontaktoni me **Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave**. Shkelja e të dhënave personale duhet t'i komunikohet menjëherë, dhe jo më vonë se pas 24 orëve, Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave (dataprotection.officer@krka.biz). Të dhënat për kontaktim të zyrtarëve të mbrojtjes së të dhënave në filialet individuale janë në dispozicion në faqen e brendshme të internetit. ([Rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale](#))

Ne e mbrojmë **reputacionin e kompanisë**. Të gjithë punonjësit duhet të familjarizohen me objektivat e rëndësishme strategjike të Krka-s, me misionin, vizionin dhe vlerat e saj. Duke i marrë parasysh këto, punonjësit duhet të ndihmojnë në krijimin e një kulture të besimit reciprok, respektit, mësimit gjatë gjithë jetës dhe punës së përgjegjshme dhe efikase. Informatat ndahen gjatë takimeve të brendshme (mbledhjeve, trajnimeve në cikël të rregullt) dhe kuvendeve të punëtorëve, nëpërmjet faqeve të brendshme të internetit, revistave të brendshme dhe komunikimeve elektronike.

Për të gjitha fotografitë, videot dhe incizimet me zë si dhe për të gjitha tekstet e krijuara në kuadër të Krka-s, një aprovim me shkrim duhet të merret nga Marrëdhëniet me Publikun (public.relations@krka.biz) para publikimit të tyre në mediat e shtypit apo digjitale për qëllime të reklamimit apo private. Vetëm personat e autorizuar për ta përfaqësuar Krka-n publikisht mund të komunikojnë me mediat në emër të kompanisë.

Komunikimi elektronik është pjesë përbërëse e marrëdhënieve tona afariste; përdoret për ta ndërtuar reputacionin e Krka-s, reputacionin e produkteve të Krka-s dhe rritjen e dukshmërisë së Krka-s. E-mail-i duhet të përdoret në mënyrë të arsyeshme dhe racionale në mënyrë që reputacioni i Krka-s të mos dëmtohet në asnjë mënyrë.

Jemi të vetëdijshëm për faktin se **rrjetet sociale** nuk ofrojnë asnjë privatësi, prandaj ne u përmbahemi vlerave të Krka-s dhe e forcojmë integritetin tonë personal kur i përdorim ato. Kur angazhohemi në mediat sociale, ne jemi të vetëdijshëm për faktin se informacionet e shpërndara në rrjetet e tilla për ne ose Krka-n mbeten të publikuara në rrjetet e tilla për një kohë të pacaktuar dhe janë në dispozicion për të gjithë ([Udhëzime për përdorimin e mediave sociale në internet për punonjësit](#)).

Asetet e kompanisë duhet të trajtohen me kujdes, duhet të përdoren për qëllimin e synuar dhe në mënyrë racionale, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e brendshme. Të gjithë punonjësit duhet t'i menaxhojnë asetet e kompanisë me kujdesin e duhur dhe ta parandalojnë humbjen, vjedhjen ose përdorimin e paautorizuar të tyre. Asetet e kompanisë janë të destinuara për nevojat e kompanisë dhe mund të përdoren vetëm për nevoja personale në rrethana të jashtëzakonshme dhe brenda qëllimit të rënë dakord ([Udhëzimet për përcaktimin e përgjegjësisë personale gjatë përdorimit të pajisjeve](#)).

Ne duhet të përmbahemi nga çdo veprim që, sa i përket natyrës së punës së kryer, që shkakton dëme materiale ose morale ose mund t'i dëmtojë interesat dhe reputacionin e biznesit të Krka. Në punën tonë, ne e mbrojmë imazhin e përgjithshëm të kompanisë dhe u përmbahemi përherë udhëzimeve, protokolleve dhe rregullave të punës të Krka-s.

Integriteti i menaxhmentit

Menaxherët ekzekutivë e marrin parasysh integritetin personal të tyre dhe parimet themelore të veprimtarisë afariste të Krka-s kur e kryejnë punën dhe detyrat e tyre. Menaxhmenti i kompanisë dhe menaxherët e lartë japin shembull me punën dhe stilin e tyre të menaxhimit, ndërsa janë esenciale për krijimin e një mjedisi të biznesit dhe punës në të cilin punonjësit dhe palët e tjera me interes mund të veprojnë në përputhje me rregulloret dhe normat etike. Menaxhmenti dhe menaxherët e lartë janë përgjegjës për informimin e punonjësve për të drejtat, obligimet, detyrat dhe të gjitha rregulloret përkatëse dhe rregullat e brendshme të kompanisë, ndërsa veprojnë në përputhje me rregullat, parimet dhe vlerat e Krka-s. Menaxhmenti i kompanisë dhe të gjithë menaxherët e lartë veprojnë me përgjegjësi ndaj pronarëve, punonjësve dhe aseteve të kompanisë kur e kryejnë punën dhe detyrat e tyre.

Në Krka, ne po e krijojmë një kulturë të besimit, respektit, bashkëpunimit dhe punës ekipore, të mësimit gjatë gjithë jetës dhe punës së përgjegjshme dhe efikase. Njohuritë, kompetencat, risitë, shprehjet e mira të punës dhe kreativiteti ynë na ndihmojnë **të veprojmë shpejt dhe të jemi fleksibilë**. Jemi duke vepruar në një mjedis biznesi në ndryshim, prandaj duhet të reagojmë shpejt ndaj kërkesave të tregut, ta ndjekim progresin, t'u përshtatemi kërkesave të ndryshme të procesit të punës dhe të gjejmë zgjidhje fleksibile. Punonjësit e Krka-s kultivojnë marrëdhënie të mira. **Partneriteti dhe besimi** përbëjnë bazën për marrëdhënie që bazohen në respektin midis të gjithë punonjësve dhe partnerëve. Ne përqijemi ta krijojmë një mjedis të punës në të cilin punonjësit ndihen të inkurajuar për të qenë **kreativë dhe efikas**. Ne i inkurajojmë punonjësit që përherë të hulumtojnë për ide të reja, të flasin rreth tyre dhe t'i realizojnë ato nëse dëshmojnë se janë të duhurat. Ne i kryejmë detyrat tona në mënyrën më të mirë dhe sipas të gjitha mundësive që i kemi, në mënyrë sa më efektive dhe sa më të shpejtë.

INTEGRITETI I KORPORATËS

Ndalimi i mashtrimit dhe korrupsionit

Parimi themelor i të gjithë punonjësve gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre është që të veprojnë sipas parimeve themelore etike dhe dispozitave të këtij *Kodi* dhe të gjitha rregulloreve dhe rregullave të brendshme të Krka-s në fuqi. **Ndalohet çdo veprim mashtrues dhe korruptiv.**

Mashtrimi dhe parandalimi i korrupsionit rregullohen me rregulla të veçanta. ([Rregullat për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit](#))

Të gjithë punonjësit e Krka-s veprojnë vazhdimisht në mënyrë etike, profesionale dhe në përputhje me rregulloret. Në Krka, vlen sa vijon:

- Ne e zbatojmë parimin e tolerancës zero sa i përket parandalimit të mashtrimit dhe korrupsionit si dhe përputhshmërisë së korporatës. Kjo do të thotë se nuk lejohet asnjë sjellje joetike, joprofesionale apo e paligjshme nga ana e punonjësve dhe partnerëve afaristë;
- Ne nuk i shfrytëzojmë mundësitë e biznesit, asetet dhe informatat e kompanisë Krka për ta përfutur avantazhe personale dhe ekonomike apo avantazhe nga ndonjë palë e tretë;
- Ne nuk premtojmë asnjë avantazh dhe nuk japim dhurata me qëllimin që të ndikojmë në vendimet e autoriteteve kombëtare, zyrtarëve publikë, partnerëve afaristë apo ndonjë subjekti tjetër, ndërsa nuk pranojmë dhurata apo ndonjë avantazh tjetër që mund të ndikojë në vendimet tona në lidhje me punën tonë;
- Ne lejojmë vetëm dhurata të rastësishme, simbolike ose promovuese me vlerë të vogël, si dhe pritje në bufe që janë tradicionale ose të zakonshme dhe ngjarje për shoqërim, siç janë ngjarjet apo takimet afariste, kulturore, sportive, arsimore e të tjera, por ato nuk duhet ta tejkalojnë qëllimin themelor të ngjarjes;
- Ne e shmangim çdo situatë që mund ta krijojë përshtypjen e dhënies së paligjshme, premtimit apo marrjes së dhuratave me vlerë më të madhe dhe avantazheve të tjera, ndërsa nuk hyjmë në

marrëdhënie afariste që përfshijnë ndonjë rrezik potencialisht serioz nga ndonjë reagim i tillë nga partnerët tanë afaristë.

Ne sigurohemi që personat që kanë qasje në **informatat e brendshme** të jenë të vetëdijshëm për nivelet e konfidentalitetit dhe ndjeshmërinë e informatave të tilla. Ne kemi rregulla të brendshme të vlefshme për tregtimin e instrumenteve financiare të kompanisë dhe kemi krijuar mekanizma të kontrollit për punonjësit dhe palët e treta që merren me informatat e tilla. Në këtë mënyrë, ne mund t'i parandalojmë abuzimet e mundshme dhe tregtimin e brendshëm. Për të gjithë personat me qasje në informatat e brendshme është përcaktuar një periudhë kohore brenda së cilës u ndalohej tregtimi i instrumenteve financiare të kompanisë.

Konflikti i interesave

Konflikti i interesave ekziston kur interesat personale të një individi ndikojnë ose mund të ndikojnë në aftësinë e një punonjësi për të marrë vendime në mënyrë të kujdesshme dhe objektive dhe për të kryer punë në dobi të Krka-s. Ky mund të jetë interes ekonomik i një individi, interes personal i tyre, interes i anëtarëve të familjes së tyre ose interes i personave të tjerë të afërm me atë individ. Konflikti mund të jetë edhe pasojë e pjesëmarrjes së një individi në shoqata të sipërmarrësve, shkencore, politike apo të tjera.

Parimi themelor është se vendimet e marra nga punonjësit duhet të jenë në interesin më të mirë të Krka-s, prandaj të gjithë punonjësit duhet t'u shmangen situatave në të cilat mund të perceptohen sikur vendimet e tyre janë marrë duke u bazuar, para së gjithash, në interesat personale të tyre e jo në interesat e Krka-s.

Ne duhet ta informojmë menjëherë eprorin tonë nëse na bëhet me dije fakti se rrethanat tona personale ose të tjera mund të ndikojnë në punën dhe gjykimin tonë ose në punën dhe gjykimin e kolegëve tanë të punës. Çdo konflikt i interesit duhet të raportohet, ndërsa ne duhet ta përjashtojmë veten nga procesi i marrjes së vendimeve afariste në rrethana të tilla.

Konflikti i interesave konsiderohet se ekziston veçanërisht në situatat në vijim:

Kur ndonjë punonjës është pronari dominues i ndonjë kompanie konkurruese apo partneri afarist të Krka-s;

- Kur ndonjë punonjës është anëtar i organeve mbikëqyrëse apo drejtuese në kompanitë konkurrencte apo kompanitë që janë partnere afariste të Krka-s;
- Kur ndonjë punonjës kryen punë apo ofron shërbime për ndonjë kompani konkurrencte apo partner afarist të Krka-s në bazë të ndonjë kontrate apo në çfarëdo baze tjetër (qoftë në këmbim të ndonjë pagese apo pa pagesë);
- Kur ndonjë punonjës merr vendime për punësimin dhe shpërbimin e anëtarëve të familjes së ngushtë.

Kur ka dyshime për ndonjë konflikt të interesave, konsultohuni me eprorin, Zyrtaret Ligjore apo Zyrtari Kryesor i Pajtushmërisë.

Gjatë kohës së punësimit tonë në Krka dhe pa ndonjë aprovim me shkrim të marrë nga Krka, ne nuk duhet ta kryejmë asnjë punë apo të lidhim asnjë biznes në emrin tonë apo në emër të ndonjë pale tjetër që hyn në kuadër të aktiviteteve të kryera nga Krka dhe që mund të përbëjë apo të perceptohet si konkurrencë e Krka-s.

Promovimi i produkteve

Marrëdhëniet midis industrisë farmaceutike dhe sektorit të mjekësisë rregullohen me standarde, rregullore dhe udhëzime etike të rrepta. **Reklamimi apo promovimi i barnave dhe produkteve të tjera të Krka-s** bëhet në përputhje me rregulloret për reklamat dhe në një mënyrë që e inkurajon përdorimin e arsyeshëm dhe të sigurt të barnave dhe produkteve të tjera. Barnat paraqiten në mënyrë objektive pa ekzagjerim të vetive të tyre. Çdo element individual i reklamës dhe të gjitha pjesët e tij, të cilat marrësi i mesazhit i sheh si tërësi koherente, janë në përputhje me përmbledhjen e aprovuar të karakteristikave të produktit. Të gjitha karakteristikat e produktit paraqiten në mënyrë të ekuilibruar dhe nuk janë mashtruese. Përfaqësuesit e marketingut kryejnë punën e tyre në përputhje me rregulloret dhe trajnohen siç duhet për promovimin e produkteve (*Kodi i promovimit i Krka-s*).

Ne marrim pjesë në **kongrese, simpoziume dhe ngjarje profesionale**, organizojmë vizita nëpër objektet tona të prodhimit dhe zhvillimit dhe organizojmë ngjarje edukative me qëllim të ofrimit të informatave profesionale për produktet e Krka-s, duke i komunikuar zbulimet mjekësore më të fundit dhe duke e prezantuar Krka-n si partner të besueshëm për publikun profesionist.

Ne i mbështesim **hulumtimet shkencore, mjekësore dhe farmaceutike** dhe programet edukative që synojnë përmirësimin e njohurive të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e informatave të përgjithshme dhe objektivë për shëndetin, masat parandaluese ndaj sëmundjeve, shenjat dhe simptomat e sëmundjeve dhe metodat e mundshme të trajtimit.

Qëllimi i **donacioneve** dhe aseteve të tjera financiare dhe jofinanciare që u jepen profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe organizatave shëndetësore është që të merren njohuri mjekësore të reja dhe të mbështetet sistemi i kujdesit shëndetësor dhe hulumtimit. Ato dokumentohen, janë transparente dhe zbatohen duke e përjashtuar mundësinë e ushtrimit të ndikimit mbi profesionistët, stafin dhe organizatat e kujdesit shëndetësor sa i përket përshkrimit, rekomandimit, shpërndarjes, shitjes ose blerjes së produkteve tona.

Të gjitha asetet financiare dhe jofinanciare që u jepen profesionistëve të kujdesit shëndetësor, organizatave, asociacioneve dhe shoqërive shëndetësore me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në kongrese profesionale, ligjërata etj., janë **transparente** dhe që nga 30 qershori i vitit 2018 publikohen në faqen e internetit të Krka-s çdo vit.

Furnizuesit dhe partnerët afaristë

Ne i verifikojmë rregullisht klientët dhe furnitorët tanë si dhe partnerët afaristë të tjerë dhe i menaxhojmë në mënyrë efikase rreziqet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet tona afariste me ta. Në këtë mënyrë, ne mund ta parandalojmë dëmtimin e mundshëm të reputacionit të Krka-s dhe humbjet në biznes.

Ne presim si vijon nga furnitorët dhe partnerët tanë afaristë:

- Ata duhet të respektojnë t'i të drejtat e njeriut dhe ta sigurojnë një mjedis pune në të cilin respektohen dinjiteti dhe privatësia e individit;
- Ata duhet të refuzojnë t'i të gjitha format e punës së paligjshme;
- Ata duhet të kenë vendosur kontrole të brendshme, sisteme të menaxhimit të rrezikut dhe sisteme për zbulimin e konflikteve të interesit, ndërsa duhet të na informojnë menjëherë për çdo konflikt të interesit që mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në Krka-n;
- Ata duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin kundër korrupsionit dhe ligjet e konkurrencës, ndërsa duhet ta menaxhojnë riskun që ndërlikohet me mashtrimet dhe abuzimet e mundshme.

Konkurrenca e ndershme

Ne i respektojmë rregulloret që e rregullojnë mbrojtjen e konkurrencës dhe, në asnjë mënyrë, nuk e parandalojmë, kufizojmë apo shtrembërojmë konkurrencën.

Ne nuk u zbulojmë konkurrentëve informata të ndjeshme të biznesit. Ne nuk përfshihemi në praktika të bashkërenduara me kompani të tjera sa u përket çmimeve të produkteve konkurruese, kufizimeve në prodhim, shitjeve, zhvillimit teknik apo investimeve, ndarjes së territoreve të shitjes apo tregjet tregtare, strategjisë së zgjerimit, produkteve të reja, konsumatorëve, kushteve të përgjithshme të shitjes etj.

Nëse mbajmë pozitë dominuese në ndonjë treg, ne nuk përfitojmë nga ajo pozitë dhe nuk imponojmë drejtpërdrejt apo tërthorazi çmime të padrejta të blerjes apo shitjes ose kushte të tjera të padrejta të tregtimit, nuk e kufizojmë prodhimin, tregjet apo zhvillimin teknik në dëm të konsumatorëve, nuk zbatojmë kushte të ndryshme për transaksionet ekuivalente me palët tregtare të tjera, duke i vënë ato në këtë mënyrë në disavantazh konkurrues, ndërsa nuk lidhim kontrata që i nënshtrohen pranimi të obligimeve shtesë nga palët e treta, të cilat, për nga natyra apo përdorimi komercial i tyre, nuk kanë lidhje me lëndën e kontratave të tilla.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Ne jemi të vetëdijshëm se sukseset tona afariste varen edhe nga sukseset e komunitetit tonë shoqëror më të gjerë.

Ne e praktikojmë përgjegjësinë tonë sociale duke **i mbështetur aktivitetet e ndryshme brenda mjedisit ku jetojmë, duke marrë pjesë në aktivitete humanitare dhe duke marrë pjesë në aktivitete që i promovojnë avancimet në fushën e shkencës, arsimit, artit dhe kulturës** dhe ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit tonë natyror. Prioritet u jepet grupeve, individëve dhe projekteve afatgjata që fokusohen në përparimin e përgjithshëm shoqëror, cilësinë më të mirë të jetës për sa më shumë njerëz dhe punën me të rinjtë dhe që janë në përputhje me misionin e Krka-s. *“Për një jetë të shëndetshme”*.

Në përputhje me misionin tonë, Krka gjithashtu ndan fonde për rinovime dhe i pajis institucionet dhe shoqëritë e ndryshme me pajisje moderne që ua mundësojnë atyre të realizojnë aktivitete më cilësore. Ne mbështesim shumë projekte kulturore në mjedisin lokal dhe jashtë vendit.

Ne kujdesemi për mjedisin dhe i respektojmë rregulloret mjedisore, ndërsa bashkëpunojmë edhe me komunitetin më të ngushtë dhe më të gjerë lokal. Ne i kemi përfshirë shqetësimet tona për përdorimin efikas të energjisë në veprimtarinë afariste, strategjinë e zhvillimit dhe projektet e investimeve tona aktuale. Në këtë mënyrë, ne mund t'i kontribuojmë reduktimit të ndikimeve negative në mjedis, që është në përputhje me udhëzimet tona për zhvillim të qëndrueshëm. Prioritet u jepet pajisjeve dhe proceseve që mund të ndihmojnë në uljen dhe përmirësimin e konsumit të burimeve primare të energjisë.

Të gjithë ne mund të përkujdesemi që t'i reduktojmë dhe ndajmë siç duhet mbeturinat që i krijojmë në kuadër të pozitës që e kemi dhe gjatë punës që e bëjmë, që ujin dhe mjetet e tjera të punës t'i përdorim më mënyrë racionale dhe që të shkaktojmë sa më pak ndotje të ujit që të jetë e mundshme. Përdorimi i duhur dhe i sigurt i kimikateve i zvogëlon rreziqet nga ndodhitë e jashtëzakonshme.

ZYRTARI KRYESOR PËR PAJTUESHMËRI

Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri, së bashku me drejtorët dhe udhëheqësit përkatës të njësive organizative në kompani, është përgjegjës për vlerësimin e vazhdueshëm të rreziqeve të pajtueshmërisë së korporatës, bashkërendimin e aktiviteteve të duhura që kanë të bëjnë me proceset individuale të biznesit, propozimin dhe krijimin e një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm, ngritjen e vetëdijes, trajnimet dhe konsultimet për avancimin e integritetit të biznesit, shqyrtimin e raporteve për sjellje të papërshtatshme dhe shkelje të rregulloreve në fuqi, rregullave të brendshme dhe parimeve etike, dhe për raportimin tek menaxhmenti i kompanisë për pajtueshmërinë e përbashkët në Krka.

Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri e mbikëqyr dhe udhëheq zbatimin e pajtueshmërisë së përbashkët, zbatimin e dispozitave nga ky *Kodi*, dhe rregullat për raportimin e shkeljeve në Krka. Drejtorët e divizioneve, departamenteve dhe shërbimeve të pavarura bashkëpunojnë me Zyrтарin Kryesor për Pajtueshmëri, ndërsa janë përgjegjës për përcaktimin e aktiviteteve të duhura dhe veprimtarive afariste sipas kompetencave të tyre. Drejtorët e filialeve dhe përfaqësive janë përgjegjës për pajtueshmërinë e veprimtarisë afariste të tyre, ndërsa i raportojnë Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri. Varësisht nga madhësia e filialit dhe përfaqësisë, në to mund të emërohen zyrtarë kryesorë për përputhshmëri.

RAPORTIMI I SJELLJEVE TË PAPËRSHTATSHME

Çdo shkelje e këtij *Kodi* mund të përbëjë shkelje të detyrave të punës dhe të çojë në masa disiplinore dhe/ose anulim të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm të kontratës së punësimit. Shkelja e rregullave të sjelljes etike dhe biznesit nga çdo partner i Krka-s mund të çojë në ndërprerjen e bashkëpunimit afarist me atë partner.

Si punonjës të Krka, ne duhet të kujdesemi përherë që t'u përmbahemi parimeve, rregullave dhe udhëzimeve, ndërsa duhet të sillemi gjithmonë në mënyrë të përgjegjshme. Në rast të dyshimit nëse sjellja e juaj, sjellja e ndonjë kolegu apo pale të tretë është në përputhje me këtë *Kod* dhe me rregulloret e rregullat e brendshme, kërkojeni këshillën e eprorit ose drejtorit të njësisë suaj organizative. Nëse natyra ose rrethanat nuk e lejojnë këtë, kërkojeni këshillën e Çështjeve Ligjore ose Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri.

Personat kontaktues dhe numrat e telefonit

- Zyrtari Kryesor për Pajtueshmëri:
- Shefi i Çështjeve Ligjore:
- Çdo person që dyshon me arsye se është bërë ndonjë shkelje e këtij *Kodi*, rregullave apo rregulloreve të brendshme të Krka-s duhet t'ia raportojë atë Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmëri. Raportet mund të dërgohen edhe me e-mail (compliance.officer@krka.biz).

Çdo punonjës duhet ta pezullojë zbatimin e ndonjë udhëzimi apo kontrate që nuk është në përputhje me rregulloret, rregullat e brendshme të Krka-s dhe këtë *Kod* dhe ta njoftojë menjëherë personin përgjegjës. Të gjitha shkeljet do të hetohen dhe shqyrtohen seriozisht.

Krka zotohet se do t'i trajtojë të dhënat e informatorit në mënyrë konfidenciale, profesionale dhe me kujdesin e duhur dhe se do ta mbrojë informatorin siç duhet nga çdo masë hakmarrëse.

Raportimi vullnetar mund t'i zvogëlojë, eliminojë apo edhe parandalojë pasojat e sjelljes joetike dhe moszbatuese, ndërsa Krka e inkurajon raportimin vullnetar nga ana e punonjësve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kodin e Sjelljes të Krka-s e ka miratuar Bordi Drejtues i Krka, dd, Novo mesto, në seancën e tij të datës 15 mars 2018, ndërsa ka qenë në fuqi nga 1 maji i vitit 2018 e më tej.

Kodi i Sjelljes i Krka-s është publikuar në faqen e brendshme të Krka-s (Krkanet) dhe në faqen publike të Krka-s.

Më datën e hyrjes në fuqi të këtij *Kodi* skadon *Kodi i Etikës i Krka*, tovarna zdravil, dd, Novo mesto, i 2 dhjetorit të vitit 2009, ndërsa ky *Kod* e zëvendëson atë në tërësi. *Kodi i Sjelljes i Krka-s* është kështu pasardhësi ligjor i *Kodit të Etikës*.

Çdo punonjës i ri informohet për përmbajtjen e *Kodit të Sjelljes të Krka-s* gjatë një seminari hyrës.

Të gjithë punonjësit e Krka-s duhet të familjarizohen me *Kodin e Sjelljes të Krka-s* brenda një viti nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Kodi i Sjelljes i Krka-s duhet të rishikohet një herë në dy vjet dhe të ndryshohet nëse është e nevojshme.